



“Hasan Prishtina”

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-244183

URL: <http://www.uni-pr.edu>

Fax: +381-38-244187

Mail: [rektorati@uni-pr.edu](mailto:rektorati@uni-pr.edu)

Rektroi

Prof. Dr. Marjan Dema

Ref. nr. 1/87

Prishtinë,

10 04 2020

Për: Z. Salvador Elmazi, drejtor i buxhetit në MFT  
CC: Z. Besnik Bislimi, Minisër i Financave dhe Tansfereve

Nga: Prof. Dr. Marjan Dema, rektor i UP-së

Lënda: KASH 2021-2023

I nderuar z. Elmazi,

Në bazë të shkressës të pranuar me datë 03.04.2020 nr. 01/330 nga MET në bazë të legjislacionit të fuqi si në vijim: Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe statutit të Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” kemi përgatitur Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023 (KASH) sipas kufijve buxhetorë të lejuar në instrukzionin e dhënë nga departamenti i buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Transfereve.

Kërkesa e Universitetit është mbi kufij buxhetorë dhe shpresojmë t’i merrni në konsideratë .

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

**I. Misioni**

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP) është institucion autonom publik për arsimin e lartë, që zhvillon arsimin akademik, kërkimet shkencore, krijimtarinë artistike, këshillimet profesionale dhe fushat e tjera të veprimtarive akademike. UP-ja ka për mision zhvillimin e një sistemi arsimor efektiv, që do t’i kontribuojë ngritjes së mirëqenies së shoqërisë, duke ofruar edukim dhe arsimim të barabartë për të gjithë qytetarët, cilësi të lartë në fushën e kërkimeve shkencore, inovacioneve dhe transferim të teknologjisë në pajtim me vlerat dhe standarde bashkëkohore duke respektuar diversitetin e një shoqërie demokratike dhe të prosperuar.

## **II. Situata aktuale**

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" në aspektin e strukturës organizative përbëhet nga 14 njësi akademike, me rreth 40,000 studentë në aftësimin dhe përgatitjen e kuadrit adekuat për tregun e punës, kuadro të cilët ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e ekonomisë së vendit. UP, si universitet publik, është bartës kryesor i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe kontribuesi kryesor në arritjen e objektivave nacionale për rritjen e pjesëmarrjes në arsimin e lartë.

Me buxhetin e vitit 2019 është investuar kryesisht në infrastrukturë, si renovime të ndryshme në të gjitha njësítë akademike, furnizim me pajisje të teknologjisë informative sipas nevojave, investim në laboratorë të njësive akademike, parapagim i qasjeve ne plotaforma shkencore, ndarja e bursave për student, mëeshtetja e stafit akademik në masë të vogël për punime shkencore etj. UP nuk ka arritur të ketë performance të mirë tek kategoria e shpenzimeve kapitale pasi kjo performancë varet edhe nga faktorët e jashtëm.

Objektiv madhor për Universitetin mbetet thellimi dhe vazhdimi i bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe harmonizimi i plan-programeve me standarde evropiane. UP gjatë vitit 2019 ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me universitete dhe institucione të ndryshme ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Sistemi i reformave në arsim, si pjesë përbërëse ka për qëllim edhe promovimin e demokracisë qytetare, zhvillimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së arsimit të lartë.

Pavarësisht këtyre rezultateve UP-ja përballet me këto sfida:

- Mungesën e hapësirave për studim dhe investimet në Objekte të reja
- Numrin e madh të studentëve në raport me numrin e mësimdhënësve (raporti i lartë Mësimdhënës/Student )
- Kërkesën për laboratorë dhe pajisjeje të IT,
- Renovime në objektet e vjetra,
- Rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie,
- Avancimin dhe rritjen e numrit të stafit akademik.

### **II.1. Objektivat**

Për të realizuar misionin e vet UP -ja për periudhën afatmesme 2021-2023, ka këto objektiva:

1. Ngritura e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
2. Rritja e kërkimeve shkencore në UP - shndërrimi i Universitetit në institucion të arsimit të lartë dhe hulumtimeve shkencore;
3. Zgjërimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës në arsimin lartë në të gjitha pjesët e infrastrukturës duke përfshirë objektet, laboratoret dhe TI.

**II.1.1. Objktivi i parë-** synon të bëjë ngritjen e cilësisë në studime, mësimdhënie dhe mësimnxënie si dhe në hulumtime shkencore sipas normave që kërkohen. Realizimi i këtij objektivi planifikohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Organizimin e Universitetit Veror të Prishtinës;
- Organizimi i Konferencave dhe Simpoziume Shkencore Nderkombetare
- Sigurimin e përfshirjes më të madhe të gjeneratës së re në arsimin e lartë, në harmoni me kërkesat e tregut të punës;
- Ngritja e cilësisë në studime, mësimdhënie, mësimenxënie dhe avancimi i kërkimeve shkencore.

**II.1.2. Objktivi i dytë** -synon avancimin e kërkimeve shkencore, shndërrimin e Universitetit në institucion të arsimit të lartë dhe të hulumtimeve shkencore. Realizimi i këtij objektivi planifikohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Integrimi dhe ndërkombëtarizimi i UP-së në proceset zhvillimore evropiane dhe botërore të kërkimeve shkencore për zgjidhjen e problemeve të shoqërisë dhe në shërbim të ekonomisë;
- Rritja e mobilitetit të mësimdhënësve/hulumtuesve dhe studentëve;
- Avancimi i kërkimeve shkencore në UP - shndërrimi i Universitetit në institucion të arsimit të lartë dhe hulumtimeve shkencore;
- Rritja e numrit të bibliotekave me literaturë shkencore; përfshirë literaturën dhe e-bibliotekat
- Hartimin e politikave për sigurim të cilësisë, certifikim, vlerësim, standarde dhe kualifikime.

**II.1.3. Objktivi i tretë**- synon eliminimin e mungesës së hapësirave në UP si dhe arritjen e standardeve në nivel me universitetet e rajonit dhe me gjerë. Realizimi i këtij objektivi planifikohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Përmirësimi i ambientit të përgjithshëm arsimor në institucionet e arsimit të lartë përmes investimeve në infrastrukturën fizike të institucioneve;
- Krijimin avancimin dhe zhvillimin e sistemit informativ në të gjitha fushat e shërbimeve në UP;
- Zgjërimin e hapsirave të reja në UP përmes ndërtimit të objekteve të reja,
- Investimet në laboratoret e UP-së me teknologji të fundit sipas trendeve ndërkombëtare dhe inovative.

**Tabela 1. Trendet e financimit 2017-2020 dhe vlerësimet 2021-2023**

Organizata buxhetore	Viti 2017 Shpenzimi	Viti 2018 shpenzuar	Viti 2019 Buxhetuar	Viti 2020 Buxhetuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
<b>Total</b>	26,371,028	29,513,418	34,785,502	34,927,725	35,118,144	35,224,127.00	36,410,462.4
Numri i punëtorëve	<b>2081</b>						
Paga	19,883,961	20,887,326	21,263,857	20,986,212	21,176,631	21,177,158.00	22,235,462.4
Mallra dhe shërbime	2,574,139.07	3,525,428	3,402,645	3,422,513	3,422,513	3,521,969.00	3,650,000.0
Shpenzime komunale	903,331	987,256	1,175,000	1,175,000	1,175,000	1,175,000.00	1,175,000.0
Subvencione dhe transfere	959,776	740,816	1,444,000	1,444,000	1,444,000	1,450,000.00	1,450,000.0
Shpenzime kapitale	2,049,820	3,372,592	7,500,000	7,900,000	7,900,000	7,900,000.00	7,900,000.0
Burimet e financimit		29,094,735	34,785,502	34,927,725	35,118,144	35,224,127.00	36,299,838.4
Garantet qeveritare	22,782,088	25,001,073	26,787,752	30,929,975	31,120,394	31,226,377.00	32,302,088.4
Financimi nga të hyrat e AKP-së		879,786	4,000,000				
Të hyrat vetanake	3,588,940	3,213,876	3,997,750	3,997,750	3,997,750	3,997,750.00	3,997,750.0
Financimet nga huamarrjet	-		-	-	-		
Financimi nga deficiti buxhetor (2%) - 04							
Financimi nga Klauzola e investimeve - 06							
Grantet nga Donatorët *							

**Kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje** - janë për stafin aktual dhe numrin e stafit të aprovuar ndërsa pa buxhet shtesë nuk mund të ketë rritje të stafit, të cilësisë në arsim dhe zvogëlimin e raportit student profesor që është i lartë krahasuar me standartet ndërkombëtare.

Në këtë kategori nuk është llogaritur kosto e pagave sipas Ligjit të pagave.

**Në kategorinë e shpenzimeve për mallra dhe shërbimeve** - do të mbulohen vetëm shpenzimet fikse, por me kufirin e lejuar nuk do të këtë buxhet për ti realizuar të gjitha aktivitet shkencore të njësive akademike dhe instituteve të cilat duhet të bëjnë kërkime, hulumtime sipas planit të punës

konkurrente në treg. UP me strategjinë zhvillimore ka parapare buxhet për shkencë 1 % të vlerës së përgjithshme të buxhetit vjetor të UP-së.

Në kategorinë e shpenzimeve komunale do të realizohen të gjitha obligimet që ka UP-ja.

**Në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere - mjetet e planifikuara janë të mjaftueshme për zbatimin e politikave bazë në UP, për mbështetjen e stafit akademik, publikime shkencore dhe mobilitet pasi me statutin e UP-së stafi është i obliguar të publikojë punime në revista me renome, e të cilat kanë një kosto të lartë.**

**Në kategorinë e shpenzimeve kapitale - mjetet buxhetore janë të mjaftueshme për realizimin e objektivave strategjike. Përveç ndërtimit të objekteve të reja, mjetet nga kjo kategori do të investohen në:**

- Modernizimin e laboratorëve të njësive akademike me pajisje të reja siç kërcohët me standarde ndërkombëtare që lidhen me fushën e hulumtimeve shkencore,
- Ngritjen e instituteve kërkimore shkencore dhe për pune me ekonominë,
- Renovimin e objekteve ekzistuese,
- Ngritjen e kapaciteteve të TI-së sipas teknologjisë së re duke përfshirë harduer dhe softuer, në fokus të veçantë automatizimin e proceseve të punës.

Andaj, duke respektuar vlerësimet e MFT-së për vitet 2021-2023 ne mendojmë se UP-së duhet ti rritet buxheti për realizimin e politikave bazë siç janë cekur në tabelën në vijim:

**Tabela 2. Kërkesa për rritje të Buxhetit për realizimin e politikave bazë**

Politika e re prioritare 1.	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
<b>Përshkrimi :</b>			
<b>Ndërlidhja e politikës së re me Dokumentet Strategjike</b>			
<b>Total</b>	2,505,956	1,312,720	1,087,660
Numri i punëtorëve			
Paga dhe mëditje	1,350,956.00	967,719.66	932,660.16
Mallra dhe shërbime	1,155,000.00	345,000.00	155,000.00
Shpenzime komunale			
Subvencione dhe transfere			
Shpenzime kapitale			
Burimet e financimit			
Grantet qeveritare	2,505,956	1,312,720	1,087,660
Financimi nga të hyrat e AKP-së			
Të hyrat vetanake			
Financimet nga huamarjet	-	-	-
Financimi nga deficiti buxhetor (2%) - 04			

Financimi nga Klauzola e investimeve -06			
Grantet nga Donatorët*			

Me mjete shtesë do të financohen këto shtylla kryesore strategjike, në përputhje me objektivat e vendosura në Planin strategjik të miratuar nga KD, si në vijim :

- **Rritja e cilësisë në Arsim, Universitet dhe Studime.** Stimulimin e kuadrit mësimdhënës me kualifikime të doktoraturës në 10 vitet e ardhshme, zhvillimi dhe zbatimi i një modeli të ri të stafit akademik globalisht konkurruesh në mësimdhënësie, hulumtime dhe të shërbimeve në UP për të arritur statusin si një institucion që renditet në mesin e institacioneve më të mira nga mbarë bota deri në vitin 2027.
- **Nxitja e Hulumtimeve Kërkimore-Shkencore.** Të mbështesim misionin tonë kërkimor duke rritur financimin institucional dhe shpenzimet kërkimore me 1% të buxhetit total çdo vit; të ofrojë investime me shenjëstër kërkimin më të avancuar dhe punën krijuese. Krijimi i një qendre dhe menaxhimi për hulumtim, mbështetje kërkimore dhe menaxhimin e fondeve nga jashtë (grante) e cila ka filluar të ngritet në vitin 2017 si Zyre për Kërkime dhe Projekte të Sponsorizuara (ZKPS).
- **Mbështetja e misionit.** Rritja e stafit të Universitetit për të mbështetur arsimin, kërkimin dhe punën krijuese, shërbimet dhe veprimet. Zhvillimi, zbatimi dhe sigurimi i një përmirësimi të vazhdueshëm në të gjitha shërbimet e UP-së nëpërmjet standardeve ndërkombëtare të kontrollit të cilësisë dhe akreditimit
- **Të mësuarit për një botë me diversitet.** Zbatimi i strategjive të reja për përmirësimin e diversitetit; të nxisej një klimë mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë.
- **Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve akademike** dhe shërbimeve studentore të fakulteteve të UP-së për të nxitur shkëmbimin maksimal dhe lejimin e kompetencave përtej kufijve.

### Planifikimi i të hyrave


UP në tri vitet e fundit ka investuar në laboratoret e fakulteteve teknike dhe në laboratoret e fakultetit të Bujqësisë. Gjithashtu në vitin 2020 ka synim të investojë në këto laboratore në mënyrë që UP të mund të gjenerojë të hyra nga puna me ekonomi. Po ashtu është planifikuar inkasimi i të hyrave nga pagesat e studentëve në bazë të UA 17/2014. Në vijim është paraqitur planifikimi i të hyrave.

**Tabela 3. Planifikimi i të hyrave**

Pershkrimi I te hyres	Viti 2018 Arkëtimi	Viti 2020 Vlerësuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
<b>Totali</b>	<b>2,933,052</b>	<b>3,997,750</b>	<b>3,997,750</b>	<b>3,997,750</b>	<b>3,997,750</b>
Të hyrat nga pagesat e studentëve		3,181,674.00	3,181,674.00	3,181,674.00	3,181,674.00
		<i>Universitet inkason të hyrat në bazë të UA 17/2014 dhe ky planifikim është bërë mbi bazën e numrit aktual të studentëve, po ashtu të hyrat e UP-së janë pjesë e buxhetit dhe shfrytëzohen sipas 5 kategorive ekonomike</i>			
		<b>2,877,545.65</b>			

sipas UA 17/2014		<b>816,076.00</b>	<b>816,076.00</b>	<b>816,076.00</b>	<b>816,076.00</b>
Të hyrat nga shitja e shërbimeve (Institutet )	<b>55,506.67</b>	<i>Universiteti aktualisht ka dy institutete që gjenerojnë të hyra nga shitja e shërbimeve por shumë shpejt pritet të hapen edhe disa institute të reja pasi në buxhetin e vitit 2019 është investuar në laboratoret e fakulteteve teknike dhe të Bujqësisë, po ashtu edhe gjatë vitit 2020 janë të buxhetuar mjetet për blerjen e paisjeve në këto fakultete dhe UP do të jetë e gatshme të lëshojë në punë labortoret për punë me ekonominë.</i>			

Me respekt,



Rektori i UP-së  
Prof. Dr. Marjan Dema  
*[Handwritten signature]*